



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 998 prot

Tiranë, më 19. 2.2020

URDHËR

Nr. 92, datë 19. 2.2020

“PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
BRENDSHËM PËR MINISTRINË E KULTURËS”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 dhe nenit 119 të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, pikës 4 të nenit 7, të ligjit nr 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 164, datë 5.10.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Kulturës”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e aktit të emërtuar “Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të brendshëm për Ministrinë e Kulturës”, bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Rregullorja e mëparshme miratuar me Urdhrin nr. 348 prot., datë 18.9.2015, shfuqizohet.
3. Ngarkohen punonjësit e Ministrisë së Kulturës për zbatimin e këtij Urdhri, si dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për komunikimin e këtij urdhri.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Elva MARGARITI

